



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, , nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 30 e datës 15 qershor 2008, nenit 6 të Udhëzimit administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe zëvendësëdrejtorëve të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.09.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËSËDREJTORËVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO ARSIMORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve/eve dhe zëvendësëdrejtorëve/eve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për vitin shkollor 2022-2023, në përbërje si vijon

1. Brahim Duriqi, DKA, Kryesues
2. Drita Islami, Drejtoreshë në SHFMU "Hasan Prishtina" Llugaxhi, anëtare
3. _____ caktohet nga MASHT

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit përzgjedhës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit përzgjedhës janë përzgjedhja e drejtorit/es dhe zëvendësëdrejtorit/es së IEAAP, duke shikuar dokumentacionin e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar, të intervistojë dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas procedurave të Udhëzimit administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe zëvendësëdrejtorëve të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

2. Mandati i anëtarëve nga DKA me numër rendor 1 dhe 2 të përcaktuar në nenin 1 të këtij Vendimi është për një vit të plotë shkollor.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

15 Nr. 020/01-52750
Lipjan, më 28.09.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

